Njoftim për përqendrim me të cilin PVV GRUP OOD, Bullgari, do të fitojë kontrollin mbi PVV SHPK NISH, Serbi

(Lënda nr. 08-161/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 17.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin PVV GRUP OOD, me seli të regjistruar në rajonin Vitosha 4, Raço Petkov Kazanxhija, hyrja B, kati i parë, Sofje, Republika e Bullgarisë, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi PVV d.o.o. NISH, me seli të regjistruar në adresën 25 Maj 65b, Crveni Krst, Nish, Republika e Serbisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesës.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

Veprimtaria kryesore e PVV GRUP OOD përfshin blerjen e mallrave ose të sendeve të tjera me qëllim rishitjen e tyre në formën e tyre origjinale, të përpunuar ose të transformuar; përfaqësimin tregtar dhe ndërmjetësimin; komisione, transaksione spedicionimi dhe të transportit; veprimtaritë që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale; shërbimet hoteliere, turistike, reklamuese, informatike, programore, impresariale ose shërbime të tjera, si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare që nuk është e ndaluar me ligj.

Personi fizik Ana Hristovska ushtron kontroll mbi PVV GRUP OOD dhe, gjithashtu, është pronare e shoqërisë LENDI GRUP SHPKNJP Shkup, me NUAS 6755500, me adresë në rr. „Londonska“ nr. 19/lok. 28, Shkup, Maqedonia e Veriut, me veprimtari kryesore ndërtimin e objekteve të tjera të infrastrukturës së ulët, të paklasifikuara diku tjetër.

Veprimtaria e PVV d.o.o. NISH është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme. Me transaksionin e propozuar, PVV GRUP OOD fiton kontroll të drejtpërdrejtë mbi PVV d.o.o. NISH dhe, rrjedhimisht, edhe kontroll mbi shoqëritë e saj të varura, si vijon:

- PVV Deponia d.o.o. Jagodinë, Serbi, veprimtaria kryesore e së cilës është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme;
- PVV Deponia Dva d.o.o. Leskovc, Serbi, veprimtaria kryesore e së cilës është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme;
- PVV Leskovc d.o.o., Serbi, veprimtaria kryesore e së cilës është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme;
- PVV Jagodinë d.o.o., Serbi, veprimtaria kryesore e së cilës është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme; dhe
- PVV Prokuple d.o.o., Serbi, veprimtaria kryesore e së cilës është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme.

PVV d.o.o. NISH dhe shoqëritë e saj të varura të lartpërmendura nuk kanë prani të drejtpërdrejtë nëpërmjet një personi juridik të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizojnë të ardhura në Maqedoninë e Veriut nëpërmjet shitjes së mallrave ose ofrimit të shërbimeve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si tregu i menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.11.2026

Shkup